



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA023

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 shtator 2022

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Apelimin e Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) është ngarkuar me shqyrtimin e apelit të paraqitur më 12 korrik 2022 nga z. Kadri Veseli (përkatësisht “Apeli” dhe “Veseli” ose “i akuzuari” ose “Mbrojtja”),² kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave (“Vendimi i Kundërshtuar”).³ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe Mbrojtja e Viktimave u përgjigjën më 25 korrik 2022 se apeli duhet të rrëzohet (përkatësisht “Përgjigjja e ZPS-së” dhe “Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave”).⁴ Veseli dorëzoi kundërpërgjigje më 1 gusht 2022.⁵

I. HISTORIKU

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit.⁶

¹ F00005, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 7 qershor 2021.

² IA023/F00002, Apeli i Ndërmjetëm i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 12 korrik 2022 (“Apeli”).

³ F00817/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 25 maj 2022 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 25 maj 2022) (“Vendimi i Kundërshtuar”).

⁴ IA023/F00003, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Ndërmjetëm i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 25 korrik 2022 (“Përgjigjja e ZPS-së”); IA023/F00004, Përgjigje e Mbrojtjes së Viktimave ndaj Apelit të Ndërmjetëm të Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 25 korrik 2022 (“Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave”).

⁵ IA023/F00005, Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Mbrojtjes së Veselit ndaj ZPS-së dhe Përgjigjes së Mbrojtjes së Viktimave ndaj Apelit të Ndërmjetëm kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 1 gusht 2022 (“Kundërpërgjigjja”).

⁶ F00026/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 30 nëntor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 26 tetor 2020, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020); F00034/A01, Aktakuza, 30 tetor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*); F00045/A03, Aktakuza e Redaktuar më tej, 4 nëntor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, e riklasifikuar si publike më 5 nëntor 2020). Versioni i korrigjuar i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021. *Shih* F00455/RED/A01, Versioni i Redaktuar Publik i Aktakuzës, KSC-BC-2020-06/F00455/A01, 3 shtator 2021, 8 shtator 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua

2. Më 4 janar 2021 dhe 6 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori dy vendime kornizë ku përcaktoi parimet mbi pranimin e viktimave pjesëmarrëse në proces.⁷

3. Më 21 prill 2021 dhe 10 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e parë dhe të dytë mbi pjesëmarrjen e viktimave me të cilët pranoi 20 viktima pjesëmarrëse në proces dhe refuzoi tetë kërkesa (përkatësisht “Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave” dhe “Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”).⁸

4. Më 18 nëntor 2021, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave (“ZPV”) dorëzoi një raport të tretë mbi kërkesat e viktimave,⁹ të cilit Veseli iu përgjigj më 10 dhjetor 2021.¹⁰

më 3 shtator 2021). Versioni i ndryshuar dhe në fuqi i Aktakuzës u dorëzua më 29 prill 2022 në vijim të konfirmimit të ndryshimit të akuzave nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. *Shih* F00777/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 6 maj 2022 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 22 prill 2022, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 22 prill 2022, versioni konfidencial me më pak redakte u dorëzua më 16 maj 2022); F00789/A05, version i redaktuar publik i Aktakuzës së Ndryshuar, 29 prill 2022 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 29 prill 2022, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 29 prill 2022) (“Aktakuza”).

⁷ F00159, Vendim Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave, 4 janar 2021 (“Vendimi i Parë Kornizë”); F00382, Vendimi i Dytë Kornizë mbi Kërkesat e Viktimave, 6 korrik 2021.

⁸ F00257/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 21 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 21 prill 2021) (“Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), para. 85(a), (f); F00611/RED, Versioni i redaktuar publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 10 dhjetor 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u protokollua më 10 dhjetor 2021) (“Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), para. 70(a)-(c).

⁹ F00572, Raporti i Tretë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces, 18 nëntor 2021 (konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 30 nëntor 2021) (“Raporti i Tretë i Zyrës Administrative”). Shtojcat 1 deri në 13 të Raportit të Tretë të Zyrës Administrative janë rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁰ F00612, Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Raportit të Tretë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces (F00572), 10 dhjetor 2021 (“Parashtrimet e Veselit”).

5. Më 25 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Kundërshtuar, me të cilin pranoi 12 viktimave pjesëmarrëse në proces dhe miratoi mosnxjerrjen e identiteteve të tyre për publikun dhe palët.¹¹

6. Më 1 qershor 2022, Veseli dorëzoi kërkesë për leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar.¹²

7. Më 10 dhe 13 qershor 2022, ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave dorëzuan përgjigjet përkatëse.¹³ Më 20 qershor 2022, Mbrojtja e Veselit dorëzoi kundërpërgjigjen përmbledhëse.¹⁴

8. Më 28 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi dy pikat e mëposhtme për apel (bashkërisht, “pikat e miratuara”):¹⁵

(i) Nëse anonimiteti i plotë i viktimave pjesëmarrëse në proces është masë e vlefshme mbrojtëse sipas neneve 22 dhe 23 të Ligjit dhe rregullës 80 të Rregullores (“Pika e Parë”); dhe

(ii) Nëse anonimiteti i plotë i viktimave pjesëmarrëse në proces shkel të drejtat themelore bazë kushtetuese dhe ndërkombëtare të të akuzuarit, të mbrojtura me nenin 21 të Ligjit, nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) dhe nenin 14 të Konventës

¹¹ Vendimi i Kundërshtuar, paras 29-33, 43-46, 50(a), (e).

¹² F00828, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelimin e Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 1 qershor 2022 (“Kërkesë për Leje”).

¹³ F00836, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelimin e Vendimit F00817, 10 qershor 2022; F00839, Përgjigje e Mbrojtjes së Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelimin e Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 13 qershor 2022.

¹⁴ F00850, Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjeve të ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelimin e Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 20 qershor 2022 (“Kundërpërgjigje e Veselit ndaj Përgjigjeve të ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave lidhur me Kërkesën për Leje”).

¹⁵ F00856, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelimin e Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 28 qershor 2022 (“Vendimi mbi Lejen për Apel”), para. 26, 35, 50. Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi të miratonte pjesën tjetër të pikave të paraqitura nga Veseli, gjegjësisht Pikën e Tretë dhe të Katërt. *Shih* Vendimin mbi Lejen për Apel, para. 42, 49, 50.

Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("KNDCP") ("Pika e Dytë").¹⁶

II. STANDARDI I RISHIKIMIT

9. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e rishikimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijimësi.¹⁷

10. Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton se, sipas rregullës 113(6) të Rregullores, dhe në bazë të rregullës 77, palët mund të kërkojnë të apelojnë vendimin që miraton ose refuzon të drejtën e viktimave për pjesëmarrje në proces dhe kërkesat për masa mbrojtëse, por vetëm mbi bazën e gabimeve ligjore.¹⁸

III. DISKUTIM

11. Fillimisht, Paneli i Apelit vëren se, ndonëse në pikat e miratuara për apel përmendet togfjalëshi "anonimitet i plotë" i viktimave pjesëmarrëse në proces, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e ka përdorur këtë terminologji në asnjë pjesë

¹⁶ Në apel, Veseli thotë se në Kërkesën për Leje për Apel, i është referuar gabimisht nenit 32 në vend të nenit 21 të Ligjit në Pikën e Dytë, dhe në Vendimin mbi Lejen për Apel, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk e korrigjoi shprehimisht këtë gabim, por u bazua në dispozitën e duhur ligjore gjatë arsyetimit. Shih Apeli, poshtëshënimi 3; Kërkesa për Leje për Apel, para. 2; Vendimi mbi Lejen për Apel, para. 10(2), 32. Paneli vëren se në fakt neni 32 i Ligjit me titull "Emërimi dhe Funksonet e Kryetarit dhe Nënkyetarit", nuk lidhet me Pikën e Dytë. Për rrjedhojë, meqë ishte gabim shtypi, Paneli i Apelit do ta shqyrtojë Pikën e Dytë nëse anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse në proces shkel të drejtat e të akuzuarit të mbrojtura me nenin 21 të Ligjit. Shih po ashtu ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-476, Judgment on the appeal of Mr Germain Katanga against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements", 13 May 2008, para. 46.

¹⁷ KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 4-14. Shih gjithashtu F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021, para. 4-7; F00005/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021), para. 4-7; F00005/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021), para. 4-7; F00005/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021), para. 4-7.

¹⁸ Shih gjithashtu rregullën 113(5) të Rregullores; Vendimi i Parë Kornizë, para. 54.

të Vendimit të Kundërshtuar.¹⁹ Sipas Panelit të Gjykatës së Apelit, pikat e miratuara lidhen me faktin nëse “anonimiteti” i viktimave pjesëmarrëse është masë mbrojtëse e vlefshme kundrejt të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë gjatë procedurës paraprake. Në kontekstin e këtij Vendimi, Paneli me anonimitet kupton mosnxjerrjen e identitetit të viktimave pjesëmarrëse për palët.²⁰ Për rrjedhojë, Paneli gjykon se pikat e miratuara nuk lidhen me masa të tjera, si mosnxjerrja e përkohshme e identitetit të viktimave pjesëmarrëse në bazë të rregullës 105 të Rregullores ose mosnxjerrja e kërkesave të viktimave për palët në bazë të rregullës 113(1) të Rregullores.

A. NËSE ANONIMITETI I VIKTIMAVE PJESËMARRËSE NË PROCES ËSHTË MASË MBROJTËSE E VLEFESHME (PIKA E PARË)

1. Parashtrimet e palëve

12. Veseli parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gabo i që arriti në përfundimin se “Rregullorja parasheh anonimitetin për viktimat”.²¹ Së pari, Veseli argumenton se, meqë neni 23(1) i Ligjit përcakton se masat mbrojtëse për viktimat parashihen në Rregullore, mundësia e anonimitetit të viktimave pjesëmarrëse në proces nuk mund të deduktohet në mungesë të një dispozite konkrete.²²

13. Së dyti, sipas Veselit, duhet bërë dallimi mes viktimave pjesëmarrëse dhe viktimave që kanë bërë kërkesë për pjesëmarrje.²³ Në veçanti, Veseli argumenton se mbështetja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në rregullën 113(1) dhe (2) të Rregullores për të justifikuar konstatimin e tij se “Rregullorja parasheh anonimitet për

¹⁹ *Krahaso* Vendimin mbi Lejen për Apel, para. 10 me Vendimin e Kundërshtuar, para. 36-46.

²⁰ *Shih po ashtu* STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/AC/AR126.3, Decision on Appeal by Legal Representative of Victims Against Pre-Trial Judge's Decision on Protective Measures, 10 April 2013 (“STL Decision”), para. 22.

²¹ Apeli, para. 13, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 36. *Shih gjithashtu* Apelin, para. 15-20.

²² Apeli, para. 14.

²³ Apeli, para. 15.

viktimat” është jorelevante dhe e gabuar, pasi trajton “mosnxjerrjen” e formularëve të kërkesave, dhe jo të identitetit të viktimave pjesëmarrëse.²⁴

14. Së treti, Veseli parashtroi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk trajtoi argumentet e tij lidhur me rregullën 80 të Rregullores, konkretisht: (i) se rregulla 80(4)(e)(i) është “masë dytësore” që synon zbatimin e një mase mbrojtëse ekzistuese, gjegjësisht atë të mosnxjerrjes së përkohshme të identitetit të një dëshmitari ose viktime pjesëmarrëse në proces në bazë të rregullës 105 ose të “anonimitetit të plotë” të dëshmitarëve sipas rregullës 80(4)(e)(ii);²⁵ dhe (ii) “anonimiteti i plotë” është vetëm për dëshmitarët, sipas, ndër të tjera, rregullës 80(4)(e)(ii).²⁶ Veseli shton se “anonimiteti i plotë” nuk parashihet në tekstet juridike të asnjë gjykate apo tribunali shtetëror ose ndërkombëtar.²⁷

15. Së fundi, në rast paqartësie, Veseli fton Panelin të zbatojë parimin *in dubio pro reo*, sipas rregullës 4(3) të Rregullores.²⁸

16. ZPS-ja përgjigjet se, së pari, apeli duhet rrëzuar në tërësi, si i dorëzuar jashtë afatit, sepse u paraqit më se një vit pasi doli Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, që për herë të parë në këtë çështje gjyqësore miratoi anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse dhe Veseli kishte pasur dy mundësi të mëparshme që të kundërshtonte bazën ligjore të këtyre masave mbrojtëse.²⁹

17. ZPS-ja parashtroi se Veseli shpërfill formulimin e qartë, objektin dhe qëllimin e Ligjit dhe të Rregullores³⁰ dhe, po kështu, Mbrojtja e Viktimave parashtroi se nuk është vetëm Rregullorja që parasheh anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse, por se

²⁴ Apeli, para. 15.

²⁵ Apeli, para. 17. *Shih gjithashtu* Apelin, para. 16.

²⁶ Apeli, para. 18-19. *Shih gjithashtu* Apeli, para. 16.

²⁷ Apeli, para. 20; Kundërpërgjigja, para. 8.

²⁸ Apeli, para. 21.

²⁹ Përgjigja e ZPS-së, para. 2, që i referohet Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave dhe Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave.

³⁰ Përgjigja e ZPS-së, para. 3-5.

dispozitat e saj mbështeten nga Ligji dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (“KPPK”).³¹ Në veçanti, si ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave argumentojnë se neni 23(1) i Ligjit u referohet posaçërisht masave mbrojtëse të përcaktuara në nenet 221 deri në 226 të KPPK-së, që përfshijnë anonimitetin për palën e dëmtuar ose viktimën.³²

18. Gjithashtu, Mbrojtja e Viktimave parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë konstatoi se rregulla 113(1), (2) dhe (5) e Rregullores i mundësojnë miratimin e masave mbrojtëse për viktimat pjesëmarrëse në proces, përfshirë anonimitetin.³³

19. Sa i përket formulimit të rregullës 80 të Rregullores, ZPS-ja parashtron se rregulla 80(4)(e)(i) padyshim parasheh anonimitet të viktimave,³⁴ dhe se rregulla 80(4)(e)(ii) nuk mund të interpretohet sikur e kufizon anonimitetin vetëm tek dëshmitarët.³⁵ Mbrojtja e Viktimave argumenton se rregulla 80(4)(e)(i) është krejt e qartë, pasi lejon mosnxjerrjen e materialeve apo informacionit që mund të zbulojë identitetin e viktimës pjesëmarrëse në proces, që është në fakt masë që miratohet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.³⁶ Mbrojtja e Viktimave kundërshton më tej argumentin e Veselit së rregulla 80(4)(e)(i) është “masë dytësore”, me argumentin se në rregullën 80(4) renditen shembuj të masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat, ndërsa rregulla 105 ka të bëjë me nxjerrjen e materialeve.³⁷ Mbrojtja e Viktimave gjithashtu sugjeron se përmendja e “anonimitetit të plotë” të një dëshmitari në rregullën 80(4)(e)(ii) mund të lidhet me marrjen në pyetje të dëshmitarëve anonimë në bazë të rregullës 147, çka do të shpjegonte përse nuk është përfshirë shprehimisht

³¹ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 11-17. *Shih gjithashtu* Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 32-33.

³² Përgjigjja e ZPS-së, para. 4, që i referohet KPPK, nenet 19(1)(1.7), 220(1)(1.3), 224; Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 11, 13-17, që i referohet KPPK-së, nenet 220(1)(1.3), 221(1) and (4), 224(1), 224(5)(5.1) dhe 224(5)(5.4).

³³ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 18-19.

³⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 5, 10.

³⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 5.

³⁶ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 22-23.

³⁷ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 24-26.

“anonimiteti i plotë” i viktimave pjesëmarrëse në proces.³⁸ ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave shtojnë se rregulla 80 e Rregullores dhe neni 23(1) i Ligjit, janë joshteruese dhe përfshijnë çdo masë të nevojshme mbrojtëse që është “e përshtatshme për rrethanat konkrete” për mbrojtjen e viktimave pjesëmarrëse në proces.³⁹

20. Më tej, ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave argumentojnë se, në kundërshtim me pretendimin e Veselit, anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse në proces parashihet në gjykata ose tribunalë shtetërorë dhe ndërkombëtarë të tjerë, si gjykatat në Kosovë, Gjykata Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) dhe Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (“DHJGJK”).⁴⁰

21. Së fundi, për t’iu përgjigjur argumentit të Veselit lidhur me zbatueshmërinë e rregullës 4(3) të Rregullores, Mbrojtja e Viktimave parashtron se Veseli nuk përmend paragrafin e parë të rregullës 4, sipas të cilit Rregullorja duhet interpretuar në pajtim me kornizën e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit, dhe nëse është e përshtatshme, me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.⁴¹

22. Në Kundërpërgjigje, Veseli parashtron se argumenti i ZPS-së për afatin e apelit është i pabazë dhe se çdo vendim i dhënë përbën vendim të pavarur të apelueshëm.⁴²

23. Veseli kundërpërgjigjet gjithashtu se në kundërshtim me pretendimin e ZPS-së dhe të Mbrojtjes së Viktimave, neni 224 i KPPK-së nuk parasheh anonimitetin e viktimave ose të palëve të dëmtuara, por vetëm të personave që do të dëshmojnë në

³⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 29. *Shih gjithashtu* Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 27-28.

³⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 5; Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 20, që i referohet rregullës 80(1), (4) dhe (5) të Rregullores. *Shih gjithashtu* Përgjigjja e ZPS-së, para. 6.

⁴⁰ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 17; Përgjigjja e ZPS-së, para. 9-11, që i referohet GJPN-së, *Prosecutor v. Ngudjolo*, ICC-01/04-02/12-140, Decision on the participation of anonymous victims in the Apeli and on the maintenance of deceased victims on the list of participating victims, 23 September 2013 (“*Ngudjolo* Apeli Decision”), para. 14, 17; ECCC, Internal Rules (Rev. 9), 16 janar 2015, Rules 23bis, 29(4)(c), (6). *Shih gjithashtu* Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, paras 39-41.

⁴¹ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 30-32.

⁴² Kundërpërgjigjja, para. 2. Veseli po ashtu parashtron se argumentet e ZPS-së duhen rrëzuar në tërësi sepse paraqiten për herë të parë në Apel.

gjykim, gjegjësisht dëshmitarët “e zakonshëm”.⁴³ Më tej, Veseli argumenton se në qoftë se Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”) do të kishte gjykuar se Rregullorja, konkretisht rregulla 80(4)(e), kishte për qëllim shtrirjen e masës së jashtëzakonshme të anonimitetit për viktimat pjesëmarrëse në proces, do ta kishte shprehur këtë.⁴⁴

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

24. Fillimisht, sa i takon afatit të apelit, Paneli i Apelit konstaton njëfarë baze në argumentin e ZPS-së së Veseli duhet ta kishte paraqitur më herët aspektin e bazës ligjore për anonimitetin e viktimave dhe nuk ka dhënë arsye për këtë. Sidoqoftë, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i shqyrtoi argumentet e Veselit lidhur me anonimitetin e viktimave dhe nuk i vlerësoi si jashtë afatit as në Vendimin e Kundërshtuar dhe as në Vendimin mbi Lejen për Apel.⁴⁵ Në këtë kontekst, dhe duke parë parasysh se Pika e Parë buron nga Vendimi i Kundërshtuar,⁴⁶ Paneli do të vlerësojnë themelësinë e saj.

⁴³ Kundërpërgjigjja, para. 4, 8. Veseli thekson se kushtet për lëshimin e urdhrit për anonimitet, sipas nenit 224(5) të KPPK-së janë “kumulative”; në veçanti, gjykatësi duhet të konstatojë se “dëshmia e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen, sa që e bën të padrejtë realizimin e ndjekjes pa të”. *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 5. *Shih gjithashtu* IA023/F00005/A01, Shtojcën 1 të Kundërpërgjigjes Përmbledhëse të Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjeve të ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave ndaj Apelit të Ndërmjetëm kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 1 gusht 2022; IA023/F00005/A02, Shtojcën 2 të Kundërpërgjigjes Përmbledhëse të Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave ndaj Apelit të Ndërmjetëm kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 1 gusht 2022, f. 563.

⁴⁴ Kundërpërgjigjja, para. 6, që i referohet KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 26 prill 2017 (“Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese”), para. 132-139.

⁴⁵ Parashtrimet e Veselit, para. 2, 4-12; Vendimi i Kundërshtuar, para. 35-36; Vendimi mbi Lejen për Apel, para. 23-26. Në Vendimin mbi Lejen për Apel, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerësoi se “një vendim i menjëhershëm i Dhomës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor pasi pyetja nëse mosnxjerrja e identitetit të viktimave është e bazuar në Ligj dhe Rregullore mund të përfitojë nga një vendim autoritar i Panelit të Gjykatës së Apelit sa më herët që të jetë e mundshme”.

⁴⁶ *Shih* Vendimi mbi Lejen për Apel, para. 23. *Contra* Përgjigjja e ZPS-së, para. 2.

25. Së pari, Paneli merr parasysh se në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se “Rregullorja parasheh anonimitetin e viktimave” mbi bazën se: (i) rregulla 113(1) dhe (2) e Rregullores parasheh që formularët e kërkesave të viktimave dhe identiteti i parashtruesve nuk duhen nxjerrë për palët; dhe (ii) rregulla 113(5) parasheh që Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të miratojë masa mbrojtëse për viktimat, në bazë të rregullës 80 që “që përfshin të gjitha masat mbrojtëse”, mes të cilave edhe mosnxjerrjen e identitetit të viktimave për palët.⁴⁷

26. Paneli rikujton se në nenin 23(1) të Ligjit thuhet se Rregullorja “parasheh mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre”⁴⁸ dhe se “këto masa mbrojtëse përfshijnë dhe mbrojtjen e identitetit.”

27. Sa i takon Rregullores, Paneli vëren se rregulla 113(1) dhe (2) trajton mosnxjerrjen e formularëve të kërkesave të viktimave pjesëmarrëse në proces, përfshirë identitetin e parashtruesve.⁴⁹ Sidoqoftë, rregulla 113(2) e Rregullores përcakton se viktimat pjesëmarrëse në proces, kur është e mundshme, dorëzojnë “kërkesë për masa mbrojtëse në bazë të rregullës 80” dhe rregulla 113(5) përcakton se trupi gjykues lëshon vendim të arsyetuar lidhur me këto kërkesa për masa mbrojtëse në bazë të rregullës 80. Siç u theksua me të drejtë nga Gjykatësi i Procedurës

⁴⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 36.

⁴⁸ *Shih gjithashtu* nenin 39(11) të Ligjit që përcakton se “Kur është e nevojshme, gjyqtari i procedurës paraprake mund të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe të dëshmitarëve”; neni 40(2) i Ligjit që përcakton se “Trupi gjykues siguron që shqyrtimi gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me rregullat e procedurës dhe provave, në respekt të plotë të drejtave të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur e Mbrojtjes së Viktimave dhe dëshmitarëve”; nenin 40(6)(f) të Ligjit që përcakton se “Para shqyrtimit gjyqësor ose gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur është e nevojshme trupi gjykues mund: [...] f. sigurojë mbrojtjen e të akuzuarve, dëshmitarëve dhe viktimave.”

⁴⁹ Rregulla 113(1) e Rregullores përcakton se “formularët e kërkesës nuk u bëhen të njohura palëve” (theksimi i shtuar). Rregulla 113(2) e Rregullores parasheh se “Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave u dorëzon palëve një raport konfidencial lidhur me sa më sipër, pa zbuluar asnjë të dhënë identifikuese të parashtruesve të kërkesave” (theksimi i shtuar).

Paraprake, rregulla 113(2) dhe (5) e Rregullores i referohet rregullës 80 në tërësi dhe i jep atij kompetencë të urdhërojë, mes “tërësisë së masave mbrojtëse”, mosnxjerrjen e identitetit të palëve dhe viktimave, në bazë të rregullës 80(4)(e)(i).⁵⁰

28. Panelit nuk i duket bindës argumenti i pambështetur i Veselit se rregulla 80(4)(e)(i) e Rregullores⁵¹ është masë dytësore që synon zbatimin e masës mbrojtëse ekzistuese, ose faktin që, meqë rregulla 80(4)(e)(ii) parasheh “anonimitet të plotë të dëshmitarëve” kjo përjashton mundësinë e miratimit të anonimitetit për viktimat pjesëmarrëse në proces.⁵² Paneli konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboit që nuk i trajtoi më tej këto argumente.

29. Në fakt, rregulla 80(4)(e)(i) e Rregullores parasheh qartë mundësinë e mosnxjerrjes për palët të identitetit të viktimave pjesëmarrëse në proces dhe të materialeve që zbulojnë identitetin e tyre. Paneli vlerëson se kjo përfshin edhe anonimitetin kundrejt palëve. Më tej, rregulla 80(5) e Rregullores përcakton që masat në rregullën 80(4) nuk janë shteruese dhe përfshijnë “çdo masë tjetër [që Paneli vlerëson] të përshtatshme për rrethanat konkrete”.⁵³

30. Për rrjedhojë dhe në kundërshtim me pretendimin e Veselit, Paneli vlerëson se rregullat përkatëse nuk janë të paqarta, sipas kuptimit të rregullës 4(3) të Rregullores, aq sa të kërkohet zbatimi i interpretimit më të favorshëm për të akuzuarin.⁵⁴

31. Sa i takon argumentit të Veselit se anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse në proces nuk parashihet në tekstet ligjore të asnjë gjykate ose tribunali shtetëror apo

⁵⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 36.

⁵¹ Rregulla 80(4)(e)(i) e Rregullores parasheh se “Paneli mund të mbajë seancë *in camera* për marrjen e vendimit nëse do të urdhërojë, ndër të tjera: [...] (e) në rrethana të jashtëzakonshme, dhe në varësi të garancive mbrojtëse të nevojshme: (i) mosnxjerrjen për palët e materialit apo informacionit që mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit apo viktimës pjesëmarrëse në procesin gjyqësor [...]”.

⁵² Apeli, para. 17-19.

⁵³ Theksimi është shtuar. Rregulla 80(5) e Rregullores përcakton se “Paneli mund të urdhërojë cilindo kombinim të masave të mësipërme, ose masa të tjera të përshtatshme për rrethanat konkrete, me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve, ose të viktimave pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.”

⁵⁴ Shih rregullën 4(1) të Rregullores. *Contra* Apeli, para. 21.

ndërkombëtar, Paneli vëren se neni 224 i KPPK-së, të cilit i referohet konkretisht neni 23(1) i Ligjit, përcakton se gjykatësi kompetent mund të urdhërojë anonimitetin e palës së dëmtuar (që quhet edhe “viktimë”⁵⁵) kundrejt të pandehurit dhe mbrojtësit, sipas disa kushteve dhe duke ndjekur një procedurë specifike. Duke marrë parasysh se palët e dëmtuara janë “palë në proces” sipas legjislacionit të Kosovës,⁵⁶ Paneli vëren se, KPPK-ja rrjedhimisht parasheh mundësinë e anonimitetit të viktimave, të drejtat për pjesëmarrje të të cilëve janë më të gjera se ato të viktimave pjesëmarrëse në proces në Dhomat e Specializuara. Bazuar në dispozitat e KPPK-së, kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara dhe jurisprudencën e GJN-së që shtjellohet më poshtë,⁵⁷ Paneli rrëzon argumentin e lartcekur të Veselit.

32. Në përfundim, Paneli konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi që arriti në përfundimin se Rregullorja parasheh anonimitet për viktimat dhe se anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse në proces gjyqësor në Dhomat e Specializuara është masë mbrojtëse e vlefshme në bazë të neneve 22 dhe 23 të Ligjit dhe rregullave 80 dhe 113 të Rregullores. Për rrjedhojë, arsyeja e parë e apelit të Veselit hidhet poshtë.

B. NËSE ANONIMITETI I VIKTIMAVE PJESËMARRËSE NË PROCES SHKEL TË DREJTAT BAZË KUSHTETUESE DHE NDËRKOMBËTARË TË AKUZUARIT (PIKA E DYTË)

1. Parashtrimet e palëve

33. Veseli parashtron se anonimiteti për viktimat pjesëmarrëse në proces vetvetiu dëmton të akuzuarin.⁵⁸ Së pari, Veseli argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që “përzgjedhi në mënyrë selektive” jurisprudencën e GJPN-së që është e vetmja gjykatë që lejon (me garanci mbrojtëse të konsiderueshme)

⁵⁵ Neni 19(7) i KPPK-së përkufizon si viktimë “personin të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale.”

⁵⁶ Shih KPPK, nenet 9(3), 19(1.15).

⁵⁷ Shih më poshtë, para. 46-47, 49.

⁵⁸ Apeli, para. 23, 30-33.

anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse në proces,⁵⁹ dhe shpërfilli vendimin e Dhomës së Apelit të Tribunalit Special për Libanin ("TSL").⁶⁰ Sipas Veselit, Vendimi i TSL-së është një "precedent bindës" për interpretimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe përcakton një qasje që ofron mbrojtje më të gjerë të akuzuarit.⁶¹

34. Së dyti, Veseli parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake keqinterpretoi shqetësimin e Mbrojtjes, që nuk është që pjesëmarrja e viktimave do të shkonte *përtej* akuzave të konfirmuara në Aktakuzë,⁶² por që (i) i akuzuari duhet të ketë të drejtën të mbrohet kundër akuzave "më vete dhe shtesë" se viktimat pjesëmarrëse në proces kanë pësuar personalisht dëm, që është rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të paraqitur në Aktakuzë dhe se (ii) kjo e drejtë do të cenohej në qoftë se viktimat pjesëmarrëse në proces do të lejoheshin të mbeteshin anonime.⁶³

35. Së treti, Veseli argumenton se, në vend që të fokusohet në dallimet zyrtare mes dëshmitarëve dhe viktimave pjesëmarrëse në proces,⁶⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të kishte shpjeguar se si pajtohet e drejta për proces ballafaques, për shembull, me faktin që Mbrojtja nuk lejohet të kundërshtojë "statusin" e viktimave pjesëmarrëse në proces, të hetojë deklaratat e rreme⁶⁵ ose të paraqesë kundërshtime të tjera.⁶⁶ Sipas Veselit, vlerësimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se palët nuk mund të kundërshtojnë besueshmërinë e secilit parashtrues kërkesë për pjesëmarrje është jorelevant, sepse rregulla 113(3) e Rregullores ka të bëjë vetëm me pranimin e

⁵⁹ Apeli, para. 23, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, poshtëshënimet 57, 59-60. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigja, para. 9.

⁶⁰ Apeli, para. 23, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, poshtëshënimi 50 dhe Vendimit të TSL-së, para. 27, 39. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 8-9.

⁶¹ Apeli, paras 23, 32. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 8-9.

⁶² Apeli, para. 24, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 37.

⁶³ Apeli, para. 24-25, që i referohet vendimit të STL-së, para. 28. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 11.

⁶⁴ Apeli, para. 26, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 38.

⁶⁵ Apeli, para. 26.

⁶⁶ Apeli, para. 28, që identifikon shembullin e kundërshtimeve "sa u përket dëshmitarëve që kanë njëfarë lidhjeje me viktimat pjesëmarrëse në proces".

viktimave në proces, jo me pjesëmarrjen e tyre.⁶⁷ Gjithashtu, Veseli argumenton se, në kundërshtim me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, rregulla 114(5) e Rregullores specifikisht parasheh se viktimat pjesëmarrëse në proces mund të kenë detyrimin të nxjerrin informacion shfajësues.⁶⁸

36. Së katërti, Veseli parashtron se ndonëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë konstatoi se duhet gjetur balanca mes interesave të Mbrojtjes nga një anë, interesave të viktimave pjesëmarrëse në proces dhe kryerjes së shpejtë të procesit gjyqësor nga ana tjetër,⁶⁹ pjesëmarrja e viktimave kushtëzohet nga respektimi i të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë, që do të cenohej nga anonimiteti i viktimave.⁷⁰ Sipas Veselit, ndryshe nga qasja e GJPN-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që nuk bëri dallimin mes të ashtuquajturave viktimave pjesëmarrëse “pasive” ose “të heshtura” dhe “aktive”, duke nënkuptuar se nuk shkaktohet asnjë dëm edhe nëse viktimat pjesëmarrëse marrin rol aktiv në proces.⁷¹ Veseli parashtron më tej se edhe viktimat pjesëmarrëse anonime “të heshtura” me gjasë mund ta dëmtojnë të akuzuarin.⁷²

37. ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave përgjigjen se Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë nuk e mori parasysh Vendimin e TSL-së, ku bazohet më së shumti Pika e Dytë e Apelit të Veselit, dhe iu referua jurisprudencës së GJPN-së që është më aktuale, duke marrë parasysh se: (i) Vendimi i TSL-së u morr në kontekstin e një kornize ligjore të ndryshme⁷³ dhe u mor përpara vendimit të Dhomës së Apelit të GJPN-së që

⁶⁷ Apeli, para. 27, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 38.

⁶⁸ Apeli, para. 28, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 38.

⁶⁹ Apeli, para. 29, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 39.

⁷⁰ Apeli, para. 29, që i referohet nenit 22(6) të Ligjit dhe Vendimit të TSL-së, para. 38.

⁷¹ Apeli, para. 30. *Shih gjithashtu* Apelin, para. 31; Kundërpërgjigjen, para. 10.

⁷² Apeli, para. 31, që i referohet Vendimit të TSL-së, para. 26.

⁷³ Përgjigjja e ZPS-së, paras 10-11, që i referohet Vendimit të TSL-së, para. 24, 28 dhe rregulla 80(4)(e)(i) e Rregullores; Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 36-38, që krahasojnë rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores me rregullën 93 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të TSL-së, (e ndryshuar më 20 shkurt 2013). *Shih gjithashtu* Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, para. 46, ku Mbrojtja e Viktimave përshkruan Vendimin e TSL-së si të “veçuar”.

rikonfirmoi se anonimiteti i viktimave është i lejueshëm;⁷⁴ (ii) Vendimi i TSL-së nuk trajton standardet relevante të të drejtave të njeriut dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me dëshminë e dëshmitarëve anonimë;⁷⁵ dhe (iii) Rregullorja, që u miratua pas daljes së vendimeve të GJPN-së dhe TSL-së, e cila, supozohet se e ka marrë parasysh këtë jurisprudencë.⁷⁶

38. ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave përgjigjen gjithashtu se apeli shtrembëron dhe shpërfill pjesë të Vendimit të Kundërshtuar, gjegjësisht faktin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur urdhëroi masat mbrojtëse, mori parasysh modalitetet dhe shkallën e pjesëmarrjes së viktimave si dhe ndikimin që mund të ketë kjo mbi anonimitetin e tyre.⁷⁷

39. ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave argumentojnë se argumentet e Veselit janë “hamendësuese” dhe “të parakohshme” sepse bazohen në zhvillime që mund të ndodhin në proces dhe gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri të ditur konkretisht se këto masa “nuk përjashtojnë mundësinë që, në të ardhmen, trupi gjykues përkatës të lëshojë vendime dhe të marrë masa shtesë që burojnë nga statusi i dyfishtë i mundshëm i viktimave”.⁷⁸ Sipas Mbrojtjes së Viktimave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk pretendoi se po lëshonte një urdhër për t’u zbatuar “gjatë

⁷⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 10, që i referohet Vendimit të Apelit *Ngudjolo*, para. 14, 17; Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 37, 39-41. Mbrojtësi i viktimave konkretisht argumenton se Vendimi i TSL-së bazohet pjesërisht mbi mungesën e një vendimi përfundimtar, asokohe, nga Dhoma e Apelit të TPN-së lidhur me anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse në proces dhe në vijim Dhoma e Apelit të TPN-së e shqyrtoi, por nuk e mori parasysh Vendimin e TSL-së, çka u bë më pas “qëndrimi standard për viktimat pjesëmarrëse” në TPN. Shih Përgjigjen e Viktimave, para. 39-41, që u referohet disa vendimeve të Dhomave të TPN-së dhe Reyes, Y.A., “The Protection of Victims Participating in International Criminal Justice”, in Tibori-Szabó, K. and Hirst, M. (Eds.), *Victim Participation in International Justice - Practitioner’s Guide*, T.M.C Asser Press, July 2017, p. 188.

⁷⁵ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 42-45. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, para. 70.

⁷⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 10.

⁷⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 7; Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 47-49, që i referohet Apelit, para. 30; Vendimi i Kundërshtuar, para. 40; TPN, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1119, Decision on victims’ participation, 18 January 2008 (“*Lubanga* Decision dated 18 January 2008”), para. 130.

⁷⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 7, që i referohet, ndër të tjera, Vendimit të Kundërshtuar, para. 40, 45; Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 50-52, 59, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 40.

gjithë procesit gjyqësor”.⁷⁹ Duke parashtruar se në këtë fazë pjesëmarrja e viktimave nuk është në atë shkallë sa mund të ndikojë në të drejtat e Mbrojtjes, Mbrojtja e Viktimave pranon se, në qoftë se viktimat pjesëmarrëse do të vendosin të kenë një rol më aktiv në proces, çështja e anonimitetit do të rishikohet bazuar në faktet e rastit konkret.⁸⁰ Sa i përket ZPS-së, ajo parashtron se drejtësia e anonimitetit të viktimave varet nga modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave në një fazë të caktuar të procesit,⁸¹ por, sidoqoftë, edhe kur viktimat merr pjesë aktivisht në proces, për shembull si dëshmitar, anonimiteti nuk është vetvetiu i padrejtë.⁸² Në këtë kontekst, ZPS-ja sjell në vëmendje se DHSGJK-ja, duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, konstatoi se formulimi i rregullës 80(4)(e)(i)(ii) të Rregullores përputhet me Kreun II të Kushtetutës.⁸³

40. Mbrojtja e Viktimave parashtron më tej se anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse në proces nuk ka ndikim në të drejtat e të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen, duke marrë parasysh se, në kundërshtim nga pretendimi i Veselit dhe Vendimi i TSL-së, fakti që viktimat pjesëmarrëse pretendojnë se kanë pësuar dëm si pasojë e krimeve të pretenduara nuk i kontribuon detyrës së Prokurorisë për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarit dhe pjesëmarrja e viktimave në proces nuk është e barabartë me një “akuzë”.⁸⁴

41. Sa i takon argumentit të Veselit lidhur me të drejtën për të kundërshtuar “statusin” e viktimave pjesëmarrëse në proces, Mbrojtja e Viktimave përgjigjet se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara “përmban garanci të mjaftueshme” që paneli kompetent të sigurohet që viktimat pjesëmarrëse në proces nuk janë të rreme apo të bazuara në dokumente të falsifikuara.⁸⁵ Mbrojtja e Viktimave më tej parashtron

⁷⁹ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 58-59, që i referohet Apelit, para. 25.

⁸⁰ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 50-52, 57.

⁸¹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 8.

⁸² Përgjigjja e ZPS-së, para. 8, 11.

⁸³ Përgjigjja e ZPS-së, para. 8, që i referohet Aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese, para. 132-139.

⁸⁴ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 53-56. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, poshtëshënimi 24.

⁸⁵ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 61.

se të kërkosh nxjerrjen e identitetit të viktimave pjesëmarrëse për t'iu përgjigjur “një rreziku hipotetik” nuk është “proporcionale ose e përligjur”.⁸⁶

42. Së fundi, Mbrojtja e Viktimave argumenton se anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse nuk e pengon Mbrojtjen të paraqesë kundërshtime të tjera në momentin e duhur në proces gjyqësor.⁸⁷ Veçanërisht, në qoftë se Mbrojtja e Viktimave do të kërkojë të paraqesë prova në bazë të rregullës 114(5) të Rregullores, Mbrojtja do të ketë “plot mundësi” të kërkojë nxjerrjen e informacionit identifikues dhe/ose materialit përkatës.⁸⁸

43. Veseli kundërpërgjigjet se GJPN-ja është “rast përjashtimor” që ka lejuar anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse në proces në mungesë të një dispozite ligjore të posaçme ose arsytimit të bazuar.⁸⁹ Më tej, sipas tij, duke mos e përfshirë anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse në proces në rregullën 80(4)(e)(ii) e Rregullores, Plenarja e Dhomave të Specializuara duket se është bazuar në qasjen e TSL-së.⁹⁰

44. Veseli gjithashtu kundërpërgjigjet se përpjekjet e ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave për t'i zbatuar dispozitat që lejojnë *dëshmitarët* anonimë edhe për *viktimat* anonime, dhe për të barazuar viktimat pjesëmarrëse me dëshmitarët me status të dyfishtë, nuk marrin parasysh faktin se, ndonëse viktimat pjesëmarrëse vendos vullnetarisht të marrë pjesë në proces, dëshmitari është i detyruar të dëshmojë në qoftë se e thërrasin.⁹¹ Pra, sipas tij, interesat e viktimave pjesëmarrëse “nuk mund të peshojnë më shumë se të drejtat bazë të të akuzuarit për gjykim të drejtë”.⁹² Veseli

⁸⁶ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 63. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, para. 62, 64.

⁸⁷ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, paras 65-67. Shih gjithashtu Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, para. 68.

⁸⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 66.

⁸⁹ Kundërpërgjigjja, para. 9. Shih më lart poshtëshënimin 73.

⁹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 9. Shih më lart poshtëshënimin 74.

⁹¹ Kundërpërgjigjja, para. 7.

⁹² Kundërpërgjigjja, para. 7.

argumenton më tej se Mbrojtja e Viktimave nuk bën dallimin mes masave të përkohshme, të cilat kanë afat deri në një moment të caktuar dhe masave të krijuara për t'u zbatuar gjatë gjithë procesit gjyqësor.⁹³

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

45. Paneli i Apelit rikujton se viktimat lejohen të bëjnë parashtrime përmes Mbrojtjes së Viktimave gjatë procedurës paraprake dhe gjykimit, "kur preken interesat personale të viktimave dhe vetëm kur kjo nuk cenon ose nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarve."⁹⁴ Neni 21(2) parasheh se në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për seanca të drejta dhe publike, në pajtueshmëri me nenin 23 të këtij ligji dhe çdo masë të urdhëruar nga Dhomat e Specializuara për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.⁹⁵ Pra, sikurse u theksua me të drejtë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe u pranua nga Mbrojtja, paneli kompetent duhet të gjejë balancën mes të drejtave dhe interesave të Mbrojtjes nga njëra anë dhe sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së viktimave, shpejtësisë së procesit gjyqësor dhe nevojës për të garantuar pjesëmarrje të njëmendtë të viktimave, nga ana tjetër.⁹⁶

46. Së pari, lidhur me argumentin e Veselit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që nuk mori parasysh Vendimin e TSL-së dhe zgjodhi të bazohej në jurisprudencën e GJPN-së, Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se Dhomat e Specializuara udhëhiqen para së gjithash nga jurisprudenca e GJPN-së dhe

⁹³ Kundërpërgjigja, para. 11, që i referohet përsëritjes së "argumenteve të pasuksesshme", për shembull në Kundërpërgjigjen e Veselit ndaj Përgjigjeve të ZPS-së dhe Viktimave lidhur me Kërkesën për Autorizim, para. 3-4.

⁹⁴ Neni 22(6) i Ligjit. *Shih gjithashtu* rregullën 114(4) të Rregullores.

⁹⁵ E drejta e të akuzuarit për gjykim të drejtë mbrohet edhe nga neni 31 i Kushtetutës së Kosovës, neni 6 i GJEDNJ-së dhe neni 14 i KNDKP-së.

⁹⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 39; ICC, *Prosecutor v. Said*, ICC-01/14-01/21-171, Judgment on the Appeal of Mr Mahamat Said Abdel Kani against the decision of Pre-Trial Chamber II of 16 April 2021 entitled "Decision establishing the principles applicable to victims' applications for participation", 14 September 2021, paras 3, 67; *Ngudjolo Apeli Decision*, para. 16; ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-3045-Red2, Decision on 32 applications to participate in the proceedings, 27 August 2013 ("Lubanga Decision dated 27 August 2013"), paras 20-23. *Shih gjithashtu* Apelin, para. 29.

instrumentet ligjore të asaj gjykate, ku përmendet shprehimisht anonimiteti për viktimat,⁹⁷ dhe nuk janë të detyruar të bazohen në precedentë gjyqësorë nga juridiksione të tjera.⁹⁸ Sidoqoftë, në interpretimin e kornizës ligjore, Dhomat e Specializuara mund t'i referohen për orientim edhe jurisprudencës së gjykatave dhe tribunaleve të tjerë, si GJPN-ja dhe TSL-ja.⁹⁹ Ndonëse vendimet e GJPN-së dhe TSL-së, ku u mbështet Gjykatësi i Procedurës Paraprake, u morën në kontekstin e kornizave të ndryshme ligjore, të cilat, në dallim nga Dhomat e Specializuara, nuk kanë dispozita të posaçme në lidhje me anonimitetin për viktimat, Paneli vlerëson se këto vendime janë relevante për t'iu përgjigjur pyetjes nëse anonimiteti i viktimave dëmton të akuzuarin në fazën aktuale të procesit.

47. Paneli është i mendimit se anonimiteti i viktimave jo domosdoshmërisht dëmton të akuzuarit në të gjitha kontekstet, veçanërisht kur shkalla e pjesëmarrjes është e kufizuar, siç është rasti i fazës aktuale të procesit para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Paneli vlerëson se dëmi ndaj të akuzuarit e për rrjedhojë nevojë për të zbuluar identitetin e viktimave varet nga modalitetet e pjesëmarrjes në proces, sipas nenit 22 të Ligjit rregullës 114 e Rregullores, që varet nga faza në të cilën ndodhet procesi gjyqësor.¹⁰⁰ Paneli vëren se viktimat pjesëmarrëse në proces kanë të drejta të kufizuara në fazën e procedurës paraprake¹⁰¹ dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake

⁹⁷ Shih më lart, para. 25-32. *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, poshtëshënimi 50.

⁹⁸ Vendimi mbi Apelin e Veselit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, para. 51; IA009/F00030, Vendim mbi Apelin kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 23 dhjetor 2021 ("Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet ndaj Juridiksionit"), para. 28, 44. *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 50.

⁹⁹ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet ndaj Juridiksionit, para. 54, 136, 169; Vendimi mbi Apelin e Gucatit, para. 9-14.

¹⁰⁰ *Ngudjolo* Appeal Decision, para. 17. Shih gjithashtu ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-471, Decision on Disclosure of Victims' Identities, 17 June 2016 ("*Ongwen* Decision dated 17 June 2016"), paras 13-14; *Lubanga* Decision dated 27 August 2013, para. 23; *Lubanga* Decision dated 18 January 2008, para. 131.

¹⁰¹ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 49, që i referohet Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 82-84, 85(d). Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi Mbrojtjen e Viktimave që, ndër të tjera (i) të ketë qasjen në të gjitha parashtrimet, transkriptet dhe provat publike dhe konfidenciale në dosjen e çështjes gjyqësore dhe t'i informojë viktimat pjesëmarrëse pa zbuluar informacion jopublik; (ii) të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim

kur urdhëroi masa mbrojtëse për këto viktimë, theksoi se masat mbrojtëse të urdhëruara në këtë fazë të procesit, përfshirë anonimitetin, “nuk përjashtojnë mundësinë që, në të ardhmen, trupi gjykues përkatës të lëshojë vendime dhe të marrë masa shtesë që burojnë nga statusi i dyfishtë i mundshëm i viktimave”.¹⁰² Paneli nuk konstaton asnjë gabim në vlerësimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake se nuk u bind nga argumenti i Mbrojtjes se “pavarësisht shkallës së pjesëmarrjes, anonimiteti i viktimave vetvetiu dëmton të akuzuarin ” dhe automatikisht bie ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë.¹⁰³

48. Trupi Gjykues thekson se roli i viktimave në proces në Dhomat e Specializuara është shumë më i kufizuar krahasuar me palët.¹⁰⁴ Pjesëmarrja e viktimave realizohet përmes Mbrojtjes së Viktimave¹⁰⁵ dhe në varësi të autorizimit dhe modaliteteve të vendosura nga paneli kompetent.¹⁰⁶ Gjithashtu, krahasuar me procedurën e

të seancave *ex parte*; dhe (iii) të bëjë parashtrime me shkrim dhe me gojë sa herë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces.

¹⁰² Vendimi i Kundërshtuar, para. 40. Pra, në kundërshtim me pretendimin e Veselit, ndonëse nuk iu referua viktimave pjesëmarrëse në proces me termat konkretë “pasivë” dhe “aktivë”, Gjykatësi i Procedurës Paraprake faktikisht e mori parasysh shkallën e pjesëmarrjes së viktimave në proces. *Shih gjithashtu* Vendimin e Kundërshtuar, para. 38, 39.

¹⁰³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 39. *Shih* Apelin, para. 23, 25, 31, 33; Kundërpërgjigjen, para. 10.

¹⁰⁴ Neni 22(3) i Ligjit përcakton “interesi personal i viktimës dhe të drejtat e viktimës në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.” *Shih ngjashëm* Ongwen Decision dated 17 June 2016, para. 11. *Shih gjithashtu* Vendimin e Kundërshtuar, para. 38.

¹⁰⁵ *Shih* nenin 22(5)-(6) të Ligjit; rregullën 114 të Rregullores. Në veçanti, rregulla 114(1) e Rregullores përcakton se “viktimat pjesëmarrëse në proces gjyqësor ushtrojnë të drejtat e tyre përmes mbrojtësit të viktimave që u caktohet, gjatë të gjitha fazave të procesit gjyqësor në përputhje me nenet 22(6) dhe 46(9) të Ligjit.” Ligji dhe Rregullorja bëjnë dallim të qartë mes Mbrojtjes së Viktimave dhe vetë viktimave pjesëmarrëse në proces gjyqësor; si p.sh. viktimat pjesëmarrëse nuk kanë qasje në materiale konfidenciale. *Shih* rregullën 114(3) të Rregullores. *Shih gjithashtu* Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 81.

¹⁰⁶ *Shih* nenin 22(6) të Ligjit. Rregulla 114(2) e Rregullores përcakto se “Mbrojtësi i viktimave ka të drejtën të bëjë deklarata hyrëse dhe përmbyllëse dhe mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake dhe të gjykimit, nëse trupi gjykues e çmon të arsyeshme” (theksimi i shtuar). Rregulla 114(4) e Rregullores përcakton se “Kurdoherë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces dhe nëse Rregullorja nuk parashikon ndryshe, Mbrojtja e Viktimave, nën mbikëqyrjen e trupit gjykues: (a) bën parashtrime me gojë dhe me shkrim; dhe (b) u bën pyetje dëshmitarëve” (theksimi është shtuar) dhe përcakton se “trupi gjykues nxjerr udhëzime të posaçme që rregullojnë pjesëmarrjen e viktimave në proces”. *Shih gjithashtu* Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 82-84, 85(d); Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 60; Vendimi i Kundërshtuar, para. 49.

zbatueshme për dëshmitarët,¹⁰⁷ rregulla 113 e Rregullores përcakton që palët mund të bëjnë parashtrime vetëm në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët,¹⁰⁸ por nuk mund të kundërshtojnë besueshmërinë ose pranueshmërinë e secilit parashtrues të kërkesës për pjesëmarrje.¹⁰⁹ Sikurse u theksua edhe nga Mbrojtja e Viktimave, përgjegjësia për të siguruar se vetëm viktimat *reale* do të marri pjesë në proces i takon panelit kompetent, i cili vlerëson pranueshmërinë e kërkesave të viktimave *prima facie*.¹¹⁰ Në kundërshtim me pretendimin e Veselit, Paneli vlerëson se kjo ofron garanci të mjaftueshme në këtë fazë të procesit gjyqësor, sepse paneli kompetent i di identitetet e viktimave dhe është në pozitë të vlerësojë ndikimin e ndonjë dëmi të mundshëm që mund të shkaktohet, si dhe të marrë masa të nevojshme.¹¹¹

49. Paneli do të trajtojë tani argumentin e Veselit se, në qoftë se lejohet që viktimat pjesëmarrëse në proces të mbeten anonime, kjo “do të përbënte akuzë anonime ndaj të akuzuarit”.¹¹² Duke mbajtur parasysh të drejtën themelore dhe kushtetuese të të akuzuarit në një proces penal për mundësi efektive për të kundërshtuar provat e paraqitura kundër tij,¹¹³ Paneli vëren që, jo vetëm Dhoma e Apelit e TSL-së, por edhe Dhomat e GJPN-së, kanë shprehur shqetësime se pjesëmarrja e viktimave anonime

¹⁰⁷ Shih p.sh. rregullat 135, 139(4), 143(2)-(3), që u referohen besueshmërisë së dëshmitarëve dhe dëshmisë së tyre.

¹⁰⁸ Rregulla 113(1)-(3) e Rregullores. Trupi Gjykses thekson se palët nuk kanë qasje në formularët e kërkesave.

¹⁰⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 38. Shih gjithashtu IA005/F00008, Vendim mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 16 korrik 2021 (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), para. 35.

¹¹⁰ Përgjigjja e Mbrojtjes së Viktimave, para. 61. Shih rregullën 113(4) të Rregullores; Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 42-43; Vendimin e Parë Kornizë, para. 29 dhe jurisprudencën e cituar aty.

¹¹¹ Shih gjithashtu, *Lubanga* Decision dated 18 January 2008, para. 131. Shih edhe ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-807-Corr, *Corrigendum* to Decision on the participation of victims in the trial and on 86 applications by victims to participate in the proceedings, 12 July 2010, para. 65.

¹¹² Shih Apelin, para. 25.

¹¹³ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese, para. 134.

mund të çojë në akuza anonime.¹¹⁴ Ndonëse Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se pjesëmarrja e viktimave në çështjen gjyqësore aktuale kufizohet në viktimat e krimeve të pretenduara të paraqitura në Aktakuzë,¹¹⁵ ai thekson gjithashtu se, pjesëmarrja e viktimave anonime, në disa rrethana, mund të cenojë të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë. Në rast se viktimat pjesëmarrëse në proces thirret si dëshmitar, për shembull, masa mbrojtëse në fuqi për këtë viktimit mund të rivlerësohet, sikurse konstatoi me të drejtë Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹¹⁶ Gjithashtu, Paneli vëren se ka forma tjera që viktimat pjesëmarrëse të marrë pjesë në proces në bazë të kornizës ligjore, që gjithashtu mund të ketë ndikim në të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë.¹¹⁷

50. Sidoqoftë, meqë rregulla 81 parasheh që palët duhet t'i dorëzojnë kërkesë panelit kompetent për të ndryshuar masat mbrojtëse, Paneli rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Trupi Gjykses duhet të sigurojnë që gjykimi të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe, kur është e nevojshme, mund të nxjerrin urdhër *proprio motu* për të

¹¹⁴ STL Decision, para. 28 ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-474, PTC I, Decision on the Set of Procedural Rights Attached to Procedural Status of Victim at the Pre-Trial Stage of the Case, 13 May 2008 ("Katanga and Ngudjolo Decision Dated 13 May 2008"), paras 180-181, citing ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-462-tEN, Decision on the Arrangements for Participation of Victims a/0001/06, a/0002/06 and a/0003/06 at the Confirmation Hearing, 22 September 2006 ("Lubanga Decision Dated 22 September 2006"), p. 7; ICC, *Prosecutor v. Abu Garda*, ICC-02/05-02/09-136, Decision on victims' modalities of participation at the Pre-Trial Stage of the Case, 6 October 2009, para. 22. Shih gjithashtu *Ngudjolo Apeli Decision*, paras 17-19.

¹¹⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 37. Shih gjithashtu Vendimin e Parë të Apelit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 16-18.

¹¹⁶ Shih *Ngudjolo Apeli Decision*, para. 17; ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-1117, Decision on Defence Request for the Identities of Potential Witnesses on the Legal Representatives of Victims' Preliminary Lists of Witnesses, 22 December 2017, paras 10-18; *Ongwen Decision* dated 17 June 2016, paras 13-14; ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07-1788-tENG, Decision on the Modalities of Victim Participation at Trial, 22 January 2010, paras 92-93. Paneli rikujton se edhe në qoftë se një viktimit pjesëmarrëse në proces do të thirret si dëshmitar, vazhdimi i anonimitetit mund të mos konsiderohet se bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit. Shih Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, para. 136. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 40, 45.

¹¹⁷ Këtu përfshihen pyetjet drejtuar dëshmitarëve të thirrur nga palët, dorëzimi i provave dhe thirrja e dëshmitarëve për të dhënë dëshmi ose paraqitja e parashtrimeve mbi fakte që lidhen me provat e Prokurorisë kundër të akuzuarit. Shih nenin 22(6) të Ligjit; rregullën 114(4)-(5) të Rregullores. Shih gjithashtu *Ngudjolo Apeli Decision*, para. 19; *Ongwen Decision* dated 17 June 2016, para. 14; *Lubanga Decision* Dated 22 September 2006, p. 7; *Katanga and Ngudjolo Decision* Dated 13 May 2008, paras 181-182; Vendimi TSL-së, para. 27.

mbrojtur të akuzuarin, dëshmitarët dhe viktimat.¹¹⁸ Veçanërisht, kur të vendosë për modalitetet e ardhshme për pjesëmarrjen e viktimave në gjykim ose në fazën e zhdëmtimit, paneli kompetent do të vlerësojë masat mbrojtëse të urdhëruara më parë dhe, në varësi të rrethanave konkrete dhe dëmit të mundshëm ndaj palëve, mund të vendosë t'i ndryshojë.¹¹⁹ Në këtë kontekst, Paneli pajtohet me konstatimet e Gjykatës së Procedurës Paraprake të paraqitura në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave se masat mbrojtëse në këtë fazë kanë shumë pak ndikim në aftësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur për dëshmitë e ardhshme¹²⁰ dhe gjykon se Mbrojtja do të ketë mundësi të bollshme të paraqesë, në kohën e duhur, kundërshtimet që i gjykon me vend.¹²¹ Për rrjedhojë, Paneli e gjykon të parakohshme dhe të panevojshme të trajtojë në këtë fazë të procesit gjyqësor, dëmet që mund të shkaktohen gjatë gjykimit ose fazës së zhdëmtimit si rezultat i pjesëmarrjes së viktimave anonime.¹²²

51. Megjithatë Paneli pranon se pjesëmarrja e viktimave anonime në disa raste mund të cenojë të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, Paneli rikujton se anonimiteti për viktimat pjesëmarrëse në proces parashihet shprehimisht në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara¹²³ dhe vlerëson se, në rrethana të veçanta,¹²⁴ sidomos duke pasur parasysh cenueshmërinë e viktimave, mund të ekzistojnë arsye për të justifikuar anonimitetin e tyre.¹²⁵ Për rrjedhojë, Paneli vlerëson se arsyetimi i

¹¹⁸ Nenet 39(11) dhe (13), 40(2), (6)(a) dhe (f) të Ligjit. *Shih gjithashtu* rregullën 116(4)(b) të Rregullores.

¹¹⁹ Paneli vëren se Mbrojtja e Viktimave deklaroi se, në qoftë se viktimat pjesëmarrëse në proces zgjedhin të kenë një rol më aktiv, "anonimiteti i tyre do të rishikohet". *Shih* Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, para. 51, 55-57, 66.

¹²⁰ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, paras 69, 80.

¹²¹ Për shembull, lidhur me informacionin shfaqësues nga viktimat pjesëmarrëse, ose zhdëmtimet. *Shih* Apeli, para. 6, 28.

¹²² *Contra* Apeli, para. 25, ku Veseli argumenton se "nëse lejohet që viktimat pjesëmarrëse në proces të mbeten anonime gjatë gjithë procesit gjyqësor, kjo do të përbente akuzë anonime ndaj të akuzuarit, çka shkel qartë të drejtat për gjykim të drejtë" (theksimi i shtuar). *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 11. Paneli merr parasysh se Mbrojtja e Viktimave deklaroi se, në qoftë se viktimat pjesëmarrëse në procesin gjyqësor zgjedhin të kenë një rol më aktiv, "anonimiteti i tyre do të rishikohet". *Shih* Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, para. 51, 55-57, 66.

¹²³ *Shih* më lart, para. 32.

¹²⁴ Rregulla 80(4)(e)(i) e Rregullores.

¹²⁵ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 43-44; Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 51-52; Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 68.

Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Kundërshtuar, kur urdhëroi masën mbrojtëse të anonimitetit duke marrë parasysh faktorë konkrete, përfshirë modalitetin e pjesëmarrjes së viktimave në fazën paraprake, nuk ishte i padrejtë dhe nuk shkeli garancitë për gjykim të drejtë sipas nenit 21 të Ligjit, nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 6 të GJEDNJ-së dhe nenit 14 të KNDCP-së.¹²⁶ Në këtë kontekst, Paneli rikujton gjithashtu se, megjithëse u fokusua më shumë në anonimitetin e dëshmitarëve sesa të viktimave pjesëmarrëse në proces, DHSGJK-ja konstatoi se formulimi i rregullës 80(4)(e)(i) dhe (ii) të Rregullores është në përputhje me Kreun II të Kushtetutës së Kosovës dhe se moszbulimi i identitetit të dëshmitarit apo miratimi i anonimitetit nuk bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës, veçanërisht me të drejtën për gjykim të drejtë që garantohet nga neni 31(4) i saj.¹²⁷

52. Duke marrë parasysh sa më lart, Paneli konstaton se anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse në proces, në këtë fazë të procesit, nuk shkel të drejtat bazë kushtetuese dhe ndërkombëtare të të akuzuarit. Për këto arsye, hidhet poshtë arsyeja e dytë e apelit të Veselit.

IV. VENDIM

53. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

RRËZON Apelin.

¹²⁶ Paneli pajtohet me Mbrojtjen e Viktimave që Veseli nuk paraqet një analizë si anonimiteti i viktimave pjesëmarrëse në proces mund të shkelë këto dispozita, dhe as burime ligjore mbështetëse. *Shih* Përgjigjen e Mbrojtjes së Viktimave, para. 42.

¹²⁷ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese, para. 132-140. Rregulla 80(4)(e) fillimisht ishte numërtuar si rregulla 77(4)(e).

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E enjte, 15 shtator 2022

Në Hagë, Holandë